



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 350 Prot

Datë 18.02. 2016

AKT PËRPUTHSHMËRIE

Nr. 02, Datë 18.02.2016

PËR DOKUMENTIN E “STRATEGJISË TERRITORIALE”

BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të neneve 9, 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar në proces hartimi, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënavë elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e “Strategjisë Territoriale”, Bashkia Elbasan.
2. Pjesë përbërëse e këtij Akti Përputhshmërie është:
 - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumentit të “Strategjisë Territoriale” të Bashkisë Elbasan.
3. Ngarkohet Bashkia Elbasan të reflektojë rekomandimet e “Raportit të Vlerësimit Teknik”, sipas hapave të përcaktuara në raport.

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË FERRITORIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

RAPORTI I VLERËSIMIT

PËR DOKUMENTIN E “STRATEGJISË TERRITORIALE”

BASHKIA ELBASAN

18.02.2016



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

Subjekti i Përputhshmërisë	Përcaktime / Komente / Rekomandime	Përputhshmëria
<p>Përputhshmëria Ligjore</p> <p>Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, -Neni 4, shkronjat a, b, c, ç, dh, f, h, j, ll -Neni 9, pika 1/a, pika 1/c, pika 1/dh, pika 1/f, pika 1/g; -Neni 9, pika 2, shkronjat a, b dhe c/i, c/ii, c/iii; -Nenet 13, 15, 20, 23, 24, 25.</p> <p>VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” Neni 18, nenet 49, 50, 51, 52, 53.</p>	<p>Sipas nenit 52 të VKM Nr. 671, Strategjia Territoriale përmban të paktën:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK-ja, PKS-ja, PSNQ-ja, në fuqi apo proçes hartimi, të cilat ndikojnë në territorin vendor; 2. Analizën metabolike dhe vlerësimin e përgjithshëm të territorit të njësisë vendore; 3. Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor; 4. Identifikimin e problematikave që rrjedhin nga analiza e mësipërme; 5. Vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore; 6. Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore; 7. Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve; 8. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë; 9. Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve; 10. Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve; 11. Hartën e sistemeve ekzistuese së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem. 	<p>Në përputhje</p>



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

Plani i Përgjithshëm Kombëtar	<p>Mbi bazën e parashikimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar zona funksionale ekonomike Elbasan do të ketë 1 Qendër Parësore përkatësish Bashkinë Elbasan. Bashkia Librazhd parashikohet si Qendër Dytësore, ndërsa bashkitë e tjera të zonës funksionale ekonomike (bashkitë Peqin, Belsh, Cërrrik, Gramsh dhe Prrenjas) do të janë Qendra Terciare (niveli i tretë).</p> <p>Orientimet e zhvillimit që rrjedhin nga PPK janë:</p> <p>Zhvillimi Urban:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar parashikon bashkinë Elbasan si Qendrën Parësore të zonës funksionale ekonomike Elbasan.2. Bashkia Librazhd parashikohet si Qendër Dytësore ndërsa bashkitë e tjera si Peqin, Belsh, Cërrrik, Gramsh dhe Prrenjas, i parashikon si Qendra Terciare.3. Nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit funksional midis qendrave primare urbane, qendrave sekondare urbane, terciare, apo të specializuara, si edhe konsolidimit të infrastrukturës së transportit publik, PPK synon të zbusë trendin humbës të popullsisë në rajon.4. Sugjeron konsolidimin e zhvillimit urban në qëndrat urbane me qëllim frenimin e fenomenit të shpërhapjes urbane në dëm të tokës bujqësore. <p>Sistemi Natyror:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Përgjatë luginave të lumenjve, të shtrihen korridoret natyrore, të cilat vendosin prioritet përdorimi natyrën dhe bëjnë lidhjen me zonat e mbrojtura mjedisore, parqet kombëtare dhe rezervatet natyrore, masivet pyjore etj.2. PPK në lidhje me përdorimin/shfrytëzimin e lumenjëve dhe degëzimeve të tyre duke vendosur vijën blu, synon të arrijë:	<p><i>Në përputhje</i></p>
--------------------------------------	--	----------------------------



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none">a) Mbrojtje nga shfrytëzimi intensiv i inerteve të lumenjëve;b) Mrojtje nga efektet e vend-depozitimeve të mbetjeve urbane;c) Mbrojtje nga efektet e aktivitetit bujqësor e industrial. <p>3. Për sa i përket vend-depozitimeve ekzistuese jo-funksionale në Elbasan, PPK rekomandon rikualifikimin dhe përshtatjen e tyre në përputhshmëri me kriteret dhe normat mjedisore si dhe njëherazi në lidhje me vend-depozimet ekzistuese, PPK propozon marjen e masave të duhura sipas standardeve të kuadrit ligjor sektorial në funksion të reduktimit të sasisë së ndotjeve të çliruara në ambient. (<i>reduktimin e sasisë së gazrave ndotës të cilët nxirren nga Uzina Mekanike në Gramsh / Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës / Uzina Metalurgjike në Elbasan / Miniera e Fe-Ni, në Përrrenjas / Poligonet e asgjësimit në Zgarë dhe Qaf-Bar të Librazhdit</i>).</p> <p>4. PPK në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025, propozon që të ndërtohet venddepoziti i zonën e Papërit, sipas standardeve të BE.</p> <p>5. Propozohet ruajtja dhe shtimi i zonave pyjore duke rritur sipërfaqet e ripyllëzuara.</p> |
|--|

Sistemi Ujor:

- 1. PPK propozon mbrojtjen e kualitetit të ujравës përgjatë lumit Shkumbin dhe degëzimeve të tij, degëve të lumit Seman, Devoll, si dhe liqenet e Dushkut në Gramsh, 69 liqenet në pllajën e Dumresë dhe 4 liqenet e Rrajcës ne Librazhd.
- 2. Propozon rritje të bashkëpunimit ndërbashkiak me qëllim mbikqyrjen dhe ruajtjen e florës dhe faunës së



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

pasur ujore dhe mbitokësore.

3. PPK propozon ruajtjen dhe krijimin e parqeve natyrore përgjatë brigjeve të lumenjëve si dhe vendosje të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur në të gjitha qendrat urbane pranë brigjeve ujore.
1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon ruajtjen e hapësirave territoriale të tokës bujqësore duke ndaluar zhvillimet urbane në tokat bujqësore.
2. Propozon ndërmarrjen e politikave nxitëse për bashkëpunimin ndërmjet fermerëve me qëllim krijimin e koorporatave/ kooperativave të afta për të qënë denjësish konkuruese në rajon.
3. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon ruajtjen e traditës vëndase të kulturave bujqësore siç janë ullishte, agrume, drithëra, vreshta, etj.
4. Plani i Përgjithshëm Kombëtar rekomandon bashkitë përkatëse për marrjen e masave të duhura në aspektin e përmirësimit të rrjetit ujor (kanalet vaditëse /kulluese).
5. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon plotësimin e zinxhirit ekonomiko-bujqësor në agropërpunimin e produkteve bujqësore (prodhim + përpunim + tregtim).
6. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon krijimin e tregjeve rionale bujqësore.

Sistemi Infrastrukturor:

1. PPK parashikon vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative.
2. Propozohet vlerësimi i mundësisë së krijimit të parqeve fotovoltaikë me qëllim shfrytëzimin e 2500 orëve vjetore diellore.



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

3. Propozohet rivlerësimi i aksit ekzistues Peqin- Elbasan- Mirakë- Librazhd- Qukës nisur nga fakti që përgjatë kësaj rruge kalon ‘Via Egnatia’. Gjurma e kësaj rruge të hershme ka qënë përcaktuese për trajktoren e re të infrastrukturës rrugore të ditëve të sotme. Gjithashtu segmenti Xhyrë- Librazhd- Krastë- Mirakë- Librazhd, sugjerohet të ridizenjohet sipas konceptit të Rrugëve “Green”, nisur nga fakti që kalon përgjatë Zonave të Mbrojtura me përparësi turizmin (kjo pikë i referohet kryesisht Strategjisë Sektoriale të Transportit 2008- 2013 ku zbatohet sipas parimit të transportit të qëndrueshëm. Ky i fundit nënkupton optimizimin e kostos, sigurisë së lëvizjes dhe mbrojtjes mjedisore).
4. PPK propozon bashkimin e akseve ekzistues Elbasan – Gramsh me atë Voskopojë – Maliq, duke ruajtur parametrat aktuale, si një aks interurban dytësor. Lidhja e këtyre dy akseve do të lidhte më shpejt qendrat urbane të Cërrikut, Gramshit me Maliqin dhe Korçën, si dhe do të krijonte një akses më të madh në qendrën turistike të Voskopojës.
5. Propozohet rigjallërimi i linjës në tërësi dhe rigjallërimi i stacioneve duke iu përgjigjur nevojave për transport të produkteve dhe mallrave nga industritë në rajon.
6. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon integrim të mëtejshëm dhe mirëfunkcionimin me kapacitë të plotë të stacioneve aktuale dhe modaliteteve që mund të ofrojë rrjeti hekurudhor.
7. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon rrjetin e bicikletave, i cili përshkon rajonin, referuar rrjetit kombëtar të bicikletave. Në këtë rajon kalon një itinerari Qendoror dhe Itinerarët Horizontale Kombëtare. Segmenti i Itinerarit Qendoror që kalon në rajon përshkon qendrat Shëngjergj – Qafa e Bushit – Krastë – Gjinari – Gramsh Voskopojë. Itinerari Horizontal që kalon në rajon përshkon qendrat Dardhë – Xhyrë – Gjinari – Tregan (Llixhat) – Papër – Belsh.
8. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon trajktoren



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

	<p>fizike, në të cilën mund të kalojë "Via Egnatia" në këtë rajon, përgjatë qendrave: Peqin – Broshkë – Elbasan (llixha) – Mirakë – Dardhë – Quqës. Aktualisht ky segment në pjesën më të madhe të tij është zëvendësuar me infrastrukturë rrugore kryesore për lëvizjen e automjeteve. Për këtë arsy propozohet rivlerësimi i sipërpërmendor i transportit rrugor në mënyrë që të integrohet gjurma e "Via Egnatia".</p> <p>9. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon përmirësimin e infrastrukturës "Soft" që të çon tek qendrat termale, në mënyrë që të sigurohet ndërlidhja dhe promovimi sa më i lartë për t'i dhënë shtysë ekoturizmit gjithashtu.</p>	
--	--	--

Rekomandime për fazat e mëtejshme të hartimit të dokumentit të planifikimit për Bashkinë Elbasan:

Strategjia, Objektivat, Projektet Prioritare	<ul style="list-style-type: none"> - Fazimi i strategjisë dhe objektivave duke patur parasysh një territor në ndryshim të vazhdueshëm, i cili në harkun e 15 viteve në vijim do të ketë zhvillime e nevoja të tjera. Një parashikim i skenareve të mundshme për këtë hark kohor do të ndihmonte identifikimin e problemeve/presioneve të ardhshme dhe kundërpërgjigjeve për zgjidhjen e drejtimin e tyre. - Përputhja e rekomandimeve të evidentuara nga analiza SWOT (territori dhe mjedisi) me projektet strategjike prioritare për të siguruar efikasitet më të lartë të veprimit në territor. - Detajimi i projekteve prioritare (fishave) edhe me kosto (të përafërt), në mënyrë që të bëhen sa më të prekshme për financues të mundshëm dhe të arrihet në një plan veprimi prioritar paraprak që i shërben Bashkisë. - Të bëhen pjesë e programeve që do të parashikojë Plani i Përgjithshëm Vendor, masat mbrojtëse dhe trajtimi i mbejteve të trashëgura industriale. - Në objektivat strategjike të zhvillimit, polet e zhvillimit janë përqëndruar vetëm në qytetin e Elbasanit duke anashkaluar njësitë e tjera administrative. Kërkohet të evidentohen potencialet që kanë njësitë e tjera administrative në mënyrë që të fuqizohen edhe ato në vetvete, si pole të rëndësishme për bashkinë Elbasan.
Planifikimi sipas sistemeve territoriale	<p>Sistemi Infrastruktural:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të parashikohet rruga Funar – Tiranë, pasi shihet si rrugë lidhëse kryesore që mund ti japë zhvillim sektorit të turizmit. - Stacioni multimodal, i cili do të integrojë stacionin e trenit dhe terminalin/et e



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

autobuzëve, kërkohet të përqëndrohen në të njëjtën zonë/hapsirë publike, e cila përkon me stacionin aktual.

Sistemi Natyror dhe Bujqësor, fokus në:

1. Evidentimin e masave për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike duke patur parasysh sidomos përmbytjet dhe thatësirat, në harkun kohor 15-vjeçar të veprimit të PPV.
2. Rígjenerimin e kurorës së gjelbër.
3. Polet të cilat evidentojnë grumbullimin e produkteve bujqësore, duhet të parashikojnë një zinxhir të gjërë të lidhur me përpunimin e këtyre produkteve, në mënyrë që sistemi të funksionojë si zinxhir ekonomik, sipas udhëzimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Sistemi Ujor, fokus në:

1. Implementimin e ndërhyrjeve "Soft" nëpërmjet hartimit të projekteve të veçanta në basenin e lumit Shkumbin.
2. Evidentimin e rrezikut me të cilin mund të haset Bashkia Elbasan përfurnizimin me ujë referuar parashikimeve përritjen e popullsisë.

Sistemi Urban, fokus në:

1. Evidentimin e shërbimeve të munguara në qendrat e njësive administrative, apo të shërbimeve që kërkojnë rivitalizim të strukturave dhe funksionimit të tyre.
2. Identifikimin e nevojës reale përzgjerimin e mundshëm të Spitalit të Elbasanit.
3. Referuar rekomandimeve përiikonstruksionin e institucioneve arsimore, të shihet mundësia e përfshirjes në strategji të kthimit të shkollës së re të Bradasheshit në shkollë polifunksionale profesionale, në përputhje me nevojat e zonës.
4. Evidentimin në Dokumentin e Strategjisë se si do të trajtohet problemi i zgjerimit të varrezave.

Rekomandime të tjera:

1. Të evidentohen qendrat me përparësi turizmi, të cilat janë asete për territorin e Bashkisë.

Në lidhje me përputhshmërinë e parimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar me Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Elbasan, rekomandohet të rishikohen si në vijim:

1. Strategja e Zhvillimit të Elbasanit duhet të shprehet dhe të argumentojë mbi



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

Itinerarin alternativ Kashar-Peqin që propozon, duke qënë se Planet Kombëtarë nuk shprehin propozime për këtë aks. Ky itinerar është i paraqitur në hartat e Strategjisë me të njëjtën simbolikë e rëndësi si të akseve rrugore të propozuara në nivel kombëtar.

2. Për qendrën e Belshit, PPK propozon vlerësimin dhe konsolidimin e qendrës si Bashki Terciare kryesisht e fokusuar në zhvillimin e turizmit natyror-liqenor dhe zhvillimin rural.
3. Mbështetur në projektet prioritare të Ministrisë së Transporteve 2014, PPK shprehet se dy Korridoret, Korridori i Gjelbër Veri-Jug dhe Korridori Blu, nuk vendosen në një aks të vetëm:
 - a) Korridori i Gjelbër Veri-Jug është një aks i shpejtë me karakter ekonomik, Hani i Hotit – Shkodër – Fier – Gjirokastër – Kakavijë.
 - b) Korridori Blu propozohet në PPK si një rrugë bregdetare-pejzazhistike me karakter turistik, i cili kalon në këto qendra: Velipojë– Shëngjin – Patok – Durrës – Divjakë – Seman – Vlorë – Dhërmi – Sarandë – Butrint.
4. Përsa i përket hartave, të cilat janë referuar nga propozimet e Planeve Kombëtare duhet të merren në konsideratë paraqitura e:
 - a) Lidhjes me rrugë të parametrave kryesore midis Lushnjës, Urës Vajgurore, Kuçovës dhe Beratit, pasi është evidentuar rishtazi vetëm lidhja e parametrave dytësore Fier – Rroskovec – Urë Vjagurore – Berat;
 - b) Aksit rrugor Kardhiq - Delvinë, pjesë e Boshtit Qendoror-Jugor.
 - c) Aksi rrugor përgjatë lumit të Drinos, si një rrugë e parametrave interurbanë dytësorë.



**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR DOKUMENTIN E STRATEGJISË TERRITORIALE
BASHKIA ELBASAN**

Bazuar në VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015, “**Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit**”, materialet që duhen dorëzuar/botuar në Registrin e Integruar të Territorit përparrë miratimit të dokumentit të Strategjisë Territoriale, janë:

- I. **Nisma e miratuar** dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;
- II. Dokumentet përbërëse të **Strategjisë Territoriale**, ku do të përfshihen:
 1. **Hartat**;
 2. **Relacionin shpjegues**.
- III. **Akti i përputhshmërisë** nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

E RËNDËSISHME

Dokumentet zyrtarë për miratim në Këshill Bashkiak dhe KKT janë:

HARTAT, të cilat duhet të paraqesin të paktën:

- a) Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;
- b) Vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
- c) Drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit;
- d) Objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve.
- e) Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit.

RELACIONI SHPJEGUES, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- a) Vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
- b) Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore;
- c) Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve;
- d) Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparrësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë;
- e) Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve.

